2.3.4. **Aktiv**et biologjike. **Nuk ka:** (Njohja fillestare aktiveve biologjike (A.SH. dhe A.GJ.) behet zakonisht ne momentin e blerjes . Njohja fillestare behet gjithashtu kur aktivet biologjike /krijohen nga aktivet ekzistuese. Gjate njohjes fillestare shoqeria duhet t'i vleresoje aktivet biologjike me kosto. SKK13)

2.3.4.1. Pas njohjes fillestare aktivet biologjike afatshkurtra nga shoqeria duhet te mbahen me kosto minus zhvleresimin.

2.3.4.2. Pas njohjes fillestare aktivet biologjike afatgjata nga shoqeria duhet te mbahen me koston e amortizuar minus zhvleresimin, te cilat i neshetrohen amortizimit.

### 2.3.5. Aktivet afatshkurtra te mbajtura per shitje. **Nuk ka**

### 2.3.6. Parapagime dhe shpenzime te shtyra. **Nuk ka.**

### 2.3.7. Investime financiare afatgjata materiale. **Nuk ka**

2.3.7.1. Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara. Ne kete post do te paraqiten aksionet apo pjeset e kapitalit qe zoteron shoqeria ne shoqerite e tjera te cilat ajo i kontrollon (mbi 50%). Ky post eshte i vlefshem vetem per PF individuale , kurse tek PF e konsoliduara nuk ekziston. Shoqerite e

kontrolluara do te perfshihen me kosto (sipas metodes blerjes.SKK.9.p.11,p.15-p.46) minus zhleresimin ne PF individuale te investitorit. SKK.14p.10.b.

2.3.7.2. Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje. Ne kete post do te paraqiten aksionet apo pjeset e kapitalit qe zoteron shoqeria ne njesite e tjera te cilat ajo ka influence te ndjeshme dhe ka siguruar pjesemarrje ne vendimmarrje (20%-50%). Ky post eshte i vlefshem vetem per PF individuale , kurse tek PF e konsoliduara nuk ekziston. Pjesemarrjet dhe siperarrjet e perbashketa do te perfshihen me kosto(sipas metodes blerjes.SKK.9.p.11,p.15-p.46) minus zhvleresimin ne PF individuale te investitorit. SKK.14p.11.b.

2.3.7.3. Aksione dhe letra te tjera me vlere. Ne kete post paraqiten letrat me vlere te kapitalit (aksione, pjese kapitali, zotime ne fonde investimesh etj.) , te detyrimeve (bono , bono korporative, obligacione, letra me vlere me maturim te caktuar, etj.). Vleresimi ne hyrje do behet me kosto ( shih. shenimet 2.3.2.3. dhe SKK.3.p.7.).Ne daten e bilancit do te vleresohen me koston e amortizuar ( shih. shenimet 2.3.2.3. dhe SKK.3.p.11- 15).

2.3.7.4. Kerkesat per t'u arketuar afatgjata . Ne kete post paraqiten huate e dhena nga shoqeria te treteve si dhe llogari te tjera te arketueshme afatgjata nga te tretet (klienta, debitore, etj.) . Kerkesat per t'u arketuar afatgjata duhet te maten fillimisht me vleren e caktuar drejtesisht (pra jo me kosto si kerkesat afatshkurtra) . Pas njohjes fillestare te tyre , shoqeria i regjistron keto kerkesa per t'u arketuar afatgjata ne bilanc me kosto te amortizuar (duke marre ne konsiderate normen e interesit efektiv dhe nominal) shen.2.3.2.3. , SKK3.p.8,p.28,p.52)

### **2.3.8. Aktive Afatgjata Materiale.**

2.3.8.1. AAM maten fillimisht me kosto. Kosto e AAM perfshin: koston e blerjes, kosto tjera te drejperdrejta, kostoja e cmontimeve dhe kosto kthimit terrenit ne gjendjen e meparshme.(SKK5p.11. )

2.3.8.2. Percaktimi i koston se AAM, te marra nga grandet qeveritare do te behet ne perputhje me SKK 10. Percaktimi i koston se AAM, te marra me qera financiare do te behet ne perputhje me SKK 7. Percaktimi i koston se AAM, te perfituara nga kombinimi i bizneseve do te behet ne perputhje me SKK 9. (SKK5p.20)

2.3.8.3. Vleresimi i mepasshem behet me :

a-politiken kontabel ose modelin e koston(=vlere kosto - amortizmin e akumuluar - ndonji humbje e akumuluar nga zhvleresimi). SKK5p.22

b-politiken kontabel ose modelin i rivleresimit(= vlere e drejte ne daten e rivleresimit - amortizmin e akumuluar te mepasshem - humbjet e akumuluar te mepasshme nga zhvleresimi). SKK5p.23

2.3.8.4. Amortizimi i AAM llogaritet mbi bazen mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe instalimet dhe mbi bazen e vleres se mbetur per makineri e pajisje, pajisjet e zyres dhe mjetet e transportit me normat e meposhtme per vitin 2011.

Ndertesat	5%
Instalimet teknike	5%
Makineri e Pajisje	20%
Pajisje informatike	25%
Mjete transporti	20%

Normat e mesiperme te amortizimit jane percaktuar nga Ligji 8438 date 28 Dhjetor 1998 dhe zbatohen nga te gjitha shoqerite dhe kane hyre ne fuqi nga data 1 janar 1999.

2.3.8.5. AAJM maten fillimisht me kosto. Kosto e AAJM llogaritet si AAM. SKK5p.50,51.

Percaktimi i koston se AAM, te marra nga grandet qeveritare do te behet ne perputhje me SKK 10.

2.3.8.6. Vleresimi i mepasshem behet me : politiken kontabel ose modelin e koston(=vlere kosto - amortizmin e akumuluar - ndonji humbje e akumuluar nga zhvleresimi). SKK5p.57

2.3.8.7. Amortizimi i AAJM llogaritet ne menyre lineare sipas viteve te percaktuara ne kontrate por jo me shume se 5 vjete. SKK5p.59,60.

2.3.8.8. AAJM- emri i mire. Ne kete post paraqitet vlere e emrit te mire ne perputhje me kerkesat e SKK 9 , dhe qe njihet si AAJM sipas SKK 5. Ai eshte vleresuar sipas SKK9.p.40 (= kosto blerje -vleren e drejte te aktiveve neto te blera nga bashkimi bizneseve, ku ne momentin e njohjes vleresohet me kosto) . Ne bilancin kontabel do te paraqitet i vleresuar me kosto minus humbjet nga zhvleresimi. SKK 9 , p.40-43 dhe SKK5p.57



qe rezulton

**2.3.9. Aktive te tjera afatgjata.** Ne kete post paraqiten:

2.3.9.1. Elemente te AAM dhe AAJM qe priten te shiten permby 12 muaj nga data e mbylles bilancit kontabel (llog.25 AA te mbajtura per shitje) , riklasifikohen si aktive afatgjata te mbajtura per shitje dhe paraqiten ne postin aktive te tjera afatgjata. Ato vleresohen me vleren me te ulet midis vleres se tyre kontabel dhe vleres se tyre se drejte minus kostot e shitjes, dhe paraqiten me vete ne bilanc.

2.3.9.2. Elemente te AAM per aktivite jo te vijueshme ( te nderprera), vleresohen me kosto.

2.3.9.3. AAM ne proces. vleresohen me kosto.

**2.3.10. Grantet. Nuk ka** (Ne kete post paraqiten grantet e marra nga shoqeria(4661-Grante afatshkurtra) , dhe qe ne parim te perputhjes se te ardhurave me shpenzimet , ende nuk jane njohur ne te ardhurat nga shoqeria. Njohja fillestare e te ardhurave te shtyra nga grantet do te behet me vleren e drejte te mjeteve monetare qe do te perfitohen nga granti , ose me vleren e drejte te aktivite qe do te mbulohet nga granti. Ne fund te vitit ushtrimor grantet paraqiten me vleren e mbetur per t'u njohur ne te ardhurat ne periudhat e ardhme.)

**2.3.11. Provizionet. Nuk ka**

2.3.11.1. Provizioni eshte nje detyrim aktual , per te cilin koha e shlyerjes ose shuma jane te pasigurta.SKK6. Njohja e provizionit:

Nje provision njihet ne bilancin kontabel kur shoqeria ka paraqitur nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluar, dhe eshte e mundur nje fluks daljesh i perfitimeve ekonomike per permbushjen e detyrimit.

Shoqeria do njohje provizionin ne bilancin e saj vetem kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese (detyrim ligjor, konstruktiv dhe alternativa e vetme eshte shlyerja e ketij detyrimi) ka ndodhur pas dates bilancit. SKK6.

Ne cdo date te bilancit , drejtimi vlereson domosdoshmerine per krijimin e provizioneve te reja dhe rivleresimin ose anulimin e provizioneve ekzistuese. SKK6p.17.

2.3.11.2. Ne kete post paraqiten detyrimet afatshkurtra-Provizionet(4631-Afatshkurter) per te cilat shoqeria nuk ka siguri te plote ne lidhje me daten dhe shumen e shlyerjes se detyrimit brenda 12 muajve , por qe mund te vleresohen ne menyre te besueshme.

2.3.11.3. Provizionet afatgjata do te njihen ne bilanc me vleren aktuale (norma e skontimit do te jete norma e interesit te tregut) te shpenzimeve te pritshme, pervec rastit kur efekti i skontimit eshte jomaterial SKK6p.19. Ne kete post paraqiten detyrimet afatgjata-Provizionet(4632-Afagjate) per te cilat shoqeria nuk ka siguri te plote ne lidhje me daten dhe shumen e shlyerjes se detyrimit pas me shume se 12 muaj nga data e mbylles bilancit, por qe mund te vleresohen ne menyre te besueshme.

**2.3.12. Bazat e konsolidimit.**

Shoqeria nuk ka kombinim te bizneseve. Shoqeria nuk zoteron, kontrollon shoqeri te tjera. Pra, shoqeria nuk pergatit pasqyra financiare te konsoliduara.

**2.3.13. Njohja e te ardhurave / shpenzimeve.**

2.5.1. Njohja e te ardhurave .

Te ardhurat do te njihen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme. Shuma e te ardhurave, qe rrjedhin nga nje transakcion, percaktohet zakonisht me nje marrveshje mes shoqerise (shitesit) dhe blesarit te mallrave ose sherbimeve (ose perdoruesit te aktivite). Te ardhurat vleresohen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e skontimeve ose rabatet e ofruara per volumin e shitur , siç specifikohet ne kontrate (SKK8).

Te ardhurat perfshijne vleren e faturave (duke i zbritur: tvsh , zbritjet e cmimit dhe kthimet) per shitjen e mallrave, produkteve, sherbimeve . Te ardhurat do te njihen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme. Arketimet jane kryer ne menyre te arsyeshme dhe priten te arketohen diferencat e mbetura.

Te ardhurat ashtu edhe shpenzimet e shoqerise per vitin ushtrimor raportues jane kontabilizuar sipas metodes se konstatimit te te drejtave dhe detyrimeve, qe do te thote se kontabilizimi eshte bere ne momentin kur

transaksioni ekonomik ndikon mbi aktivet neto te shoqerise, dhe jo ne momentin e hyrjes ose daljes se parave qe shoqerojne transaksionin.

#### 2.5.2. Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet do te njihen me vleren e drejte te shumes se paguar ose te pagueshme. Shuma e shpenzimeve , qe rrjedhin nga nje transaksion, percaktohet zakonisht me nje marrveshje mes shoqerise (bleresit) dhe shitesit te mallrave ose sherbimeve (ose perdoruesit te aktivitetit).

#### 2.3.14. Te ardhurat / shpenzimet financiare.

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane bere te njohura si te ardhura dhe shpenzime ne pasqyren e te ardhurave sipas rrjedhjes tyre.

#### 2.3.15. Rivleresime dhe provizione per AAM.

Nuk jane kryer rivleresime dhe provizione per AAM.

#### 2.3.15. Demtimi (humbje e vleres) i asetëve.

Shoqeria nuk ka percaktuar ndonji tregues per zhvleresim te asetëve.

#### 2.3.16. Tatimi.

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit perfshin tatimin koherent dhe te shtyre.

Shpenzimi i tanishem i tatimit mbi fitimin bazohen ne detyrimin per tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal ne Shqiperi . Norma e tatimit mbi fitimin gjate vitit 2005 ishte 23% gjate vitit 2006 dhe 2007 ishte 20 % , kurse nga viti 2008 e ne vazhdim eshte 10 %.

#### 2.3.17. Monedhat e huaja .

Veprimet ne valuta te huaja kthehen ne ("Lekë") e regjistrohen me kurset e kembimit te dates se veprimit/transaksionit. Diferencat e realizuara nga luhatja e Lekut shqiptar ("Lekë") dhe kurseve te kembimit rregjistrohen ne daten e mbylljes se bilancit. Diferencat e realizuara nga luhatja e kurseve te kembimit regjistrohen si ze ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per gjendjet ne monedhe te huaj ne fund te vitit te arkes dhe bankes.

#### 2.3.18. Kontratat e mallrave te destinuara per perdorim vetiak.

Shoqeria nuk perdor mallra per nevojat e veta me qellim prodhimi, konsumi etj.

#### 2.3.19. Qiradhenie financiare. Nuk ka

Qirate financiare vleresohen ne njohjen e tyre fillestare si detyrime, sipas rregullave te percaktuara ne SKK7.p.32-39,39-45. Paraqitja ne bilanc si detyrime afatgjata do te behet e vleresuar me koston e amortizuar sipas SKK7. Keto detyrime do te paraqiten se bashku me shumen e interesit te maturuar por ende te papaguar.

Shoqeria nuk ka kontrata qeradhenie financiare.

#### 2.3.20. Qiradhenie operacionale. Nuk ka

Shoqeria ka kontrata qeradhenie operacionale.

#### 2.3.21. Kapitali i nenshkruar (aksioner).

##### 2.3.21.1. Pjeset e kapitalit.

Pjeset e kapitalit te emetuara dhe plotesisht te paguara jane klasifikuar si kapitale te veta (si e drejte zoterimi e ortakut).

##### 2.3.21.2. Dividentet .

Dividentet njihen si detyrime ne vitin ne te cilin deklarohen, por shoqeria Nuk ka bërë ndarje dividenti.

#### 2.3.22. Ngjarjet pas dates bilancit kontabel .

Shoqeria nuk ka ngjarje te ndodhura pas dates bilancit kontabel.

Asetet dhe detyrimet do te pershtateshin per ngjarjet ( nese do te kishte) qe rrjedhin midis dates mbylljes bilancit kontabel dhe dates aprovimit te pasqyrave financiare nga Drejtimi, ne rastin kur keto ngjarje

sigurojne informacion shtese per vleresimin e shumave qe lidhen me ngjarjet ekzistuese ne daten e bilancit ose nenkuptojne parimin e vijimesise ne relacionin e pjeseve ose teresine e grupit eshte e pa aprovuar.

### 2.3.23. Vlera krahasuese

Vlerat jane krahasuese dhe nuk ka ndryshim te politikave kontabel te raportimit ne vitin 2012 ne krahasim me vitin e 2011.

## SHENIME PER ZERAT (ELEMENTET) E PASQYRAVE FINANCIARE KRYESORE.

### 3. Te ardhurat

Te ardhurat perbehen nga :

0 leke nga shitja e mallrave,

0 leke nga shitja e produkteve ,

56,900,182 leke nga shitja e sherbimeve

56,900,182 leke, totali i te ardhurave per vitin 2012

Keto te ardhura perbehen nga sherbimet e kryera ndaj te treteve.

**4. Materialet e konsumuara** (kosto e lendeve te para dhe ndihmese te perdorura ) perfshim koston e ledneve te para(pjeseve te kembimit,) dhe te materialeve ndihmese. Shih detajimin e bere tek pasqyra nr. 1

### Pasqyra nr. 1

#### Pasqyra analitike e shpenzimeve per vitin 2012

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Vlefta
<b>1</b>	<b>Blerjet e ushtrimit</b>	<b>39,950,630.00</b>
A	Importe	
B	Blerje te brendeshme	39,885,499.00
C	Ndryshimi i gjendjeve	65,131.00
C/1	Gjendja ne fillim	1,224,664.00
C/2	Gjendja ne fund	1,159,533.00
<b>2</b>	<b>Furnitura</b>	<b>6,938,597.00</b>
a	Kancelari	25,779.00
b	Materiale ndihmese	5,242,718.00
d	Telefon	842,037.00
f	Sigurim oferte dhe kontrate	84,432.00
g	Siguracion mjete	112,681.00
h	Noterizim dokumentash	100,125.00
i	Kontroll periodik kasa fiskale	6,000.00
j	Mbyllje llogari vjetore + auditim viti 2009	90,000.00
	Gazoil	298,500.00
	Blerje dokumenta tenderi	8,333.00
	Raport vleresimi per truall+ndertese	22,000.00
k	Taksa vendore	25,120.00
l	Komision bankar	80,872.00



<b>3</b>	<b>Shpenzime per personelin</b>	<b>4,577,267.00</b>
<i>a</i>	<i>Pagat</i>	<i>3,922,250.00</i>
<i>b</i>	<i>Sigurime shoqerore dhe te ngjashme</i>	<i>655,017.00</i>
<b>4</b>	<b>Amortizime dhe provizione</b>	<b>1,235,870.00</b>
	<b>Shuma e shpenzimeve</b>	<b>52,702,364.00</b>

#### 5. Kosto e punes.

Shih detajimin sipas pasqyres 1.

Kosto e punes eshte vetem paga dhe sigurime shoqerore. Nuk ka shperblime dhe honorare. Shih PASH, nr. 5

#### Pasqyra nr. 2

<b>Kosto e punes</b>	<b>4,577,267.00</b>
<i>Pagat</i>	<i>3,922,250.00</i>
<i>Sigurime shoqerore dhe te ngjashme</i>	<i>655,017.00</i>

#### 6. Kosto financiare. Nuk ka

#### 7. Fitimi i shfrytezimit shih pasqyren e meposhteme:

Fitimi para tatimit eshte 3,915,533 leke.

Shih nr. 9 tek PASH dhe piken nr. 3 me siper.

#### 8. Taksat

Tatim fitimi per vitin 2012 del ne nje vlere prej 391,533 leke (fitimi para tatimit 3,915,533 leke X 10%). Deri ne 31.12 jane parapaguar gjithsej 1,187,297 leke, diferenca midis tyre (1,187,297 leke-391,533 leke) ne shumen prej 795,744 leke, eshte tatim fitimi i mbi paguar, i cili do te mbartet per vitin 2013.

#### 8.1. TATIME TE SHTYRA

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor tatime te shtyra.

#### AKTIVET AFATSHKURTRA

#### 9. Aktivet monetare.

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, gjendjet e aktiveve monetare ne fund te vitit ushtrimor jane paraqitur me vleren e drejte. Shen.2.3.1.

Veprimet ne valuta te huaja kthehen ne "leke" e regjistrohen me kurset e kembimit te dates se veprimit / transaksionit. Diferencat e realizuara nga luhatja e kurseve te kembimit rregjistrohen ne daten e mbylljes se bilancit.

Gjendja e bankave ne 31.12.2012 eshte 970,136 leke dhe gjendja e arkes 986,500 leke.

#### 10. Derivatet dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim.

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim. Shen.2.3.2.1. dhe 2.3.2.2..

#### 11. Aktive te tjera financiare afatshkurtra.

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor, 13,959,384 leke, te cilat jane detyrimet e klienteve ndaj shoqerise sone

## 12. Inventari.

12.1. Gjendjet e inventarve (pa perfshire parapagesa per furnizime) te shoqerise ne fund te vitit ushtrimor eshte 1,159,533 leke dhe eshte vleresuar dhe paraqitur ne bilancin kontabel me metoden kosos mesatare te ponderuar te kostove te marrjes, dhe jo me me vleren me te ulet midis kosos dhe vleres neto te realizueshme. Shen.2.3.3.1. Shen.2.3.3.2.. Gjendja ne fund te vitit eshte paraqitur ne total tek pasqyra nr. 1

## 13. Aktive biologjike afashkurtra.

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aktive biologjike afashkurtra . Shen.2.3.4.1.

## 14. Aktive afatshkurtra te mbajtura per shitje.

Ne bilancin kontabel te vitit 2012 , shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aktive afatshkurtra te mbajtura per shitje . Shen.2.3.5. .

## 15. Parapagime dhe shpenzime te shtyra,

Ne bilancin kontabel te vitit 2012 , shoqeria **nuk ka** parapagime dhe shpenzime te shtyra.

## AKTIVET AFATGJATA

### 16. Investime financiare afatgjata materiale.

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara . Shen.2.3.7.1. .

### 17. Aktive afatgjata materiale.

Ne bilancin kontabel te vitit 2012 , shoqeria ka per vlere neto AAM ne vleren 6,328,494 leke, shih pasqyren nr 4, te detajuar sipas llojeve te AAM-ve si dhe pasqyrat e tjera per AAM, amortizimin e tyre si dhe levizjet e tyre gjate vitit.

### Pasqyra nr. 3

#### Aktivët Afatgjatë Materiale me vlere fillestare 2012

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2012	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2012
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri e pajisje		7,086,244.0	240,000.0		7,326,244
4	Mjete transporti		2,451,275.0	0.0		2,451,275
5	Pajisje zyre		63,417.0	406,670.0		470,087
6	Pajisje informatike		87,319.0	0.0	0	87,319
						0
						0
						0
	<i>TOTALI</i>		<i>9,688,255</i>	<i>646,670</i>	<i>0</i>	<i>10,334,925</i>

Amortizimi A.A.Materiale 2012

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2012	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2012
1	Toka		0	0		0



2	Ndertime					0
3	Makineri e pajisje		2,592,580.0	906,733.0		3,499,313
4	Mjete transporti		1,225,665.0	245,122.0		1,470,787
5	Pajisje zyre		26,889.0	75,083.0		101,972
6	Pajisje informatike		51,590.0	8,932.0		60,522
						0
						0
						0
	<i>TOTALI</i>		<i>3,896,724</i>	<i>1,235,870</i>	<i>0</i>	<i>5,132,594</i>

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2012

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2012	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2012
1	Toka		0		0	0
2	Ndertime		0		0	0
3	Makineri e pajisje		4,493,664	240,000	906,733	3,826,931
4	Mjete transporti		1,225,610	0	245,122	980,488
5	Pajisje zyre		36,528	406,670	75,083	368,115
6	Pajisje informatike		35,729	0	8,932	26,797
						0
						0
						0
	<i>TOTALI</i>		<i>5,791,531</i>	<i>646,670</i>	<i>1,235,870</i>	<i>5,202,331</i>

**18. Aktive biologjike afatgjata.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012 , shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor Aktive biologjike afatgjata . Shen.2.3.4.2. .

**19. Aktive afatgjata jomateriale.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor aktive afatgjata jomateriale. Shen.2.3.8.(6,7,8).

**20. Kapitali aksionar i papaguar.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor Kapital aksionar te pa paguar.

**21. Aktive te tjera afatgjata.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor aktive te tjera afatgjata. Shen.2.3.9.(1,2,3).

**PASIVET AFATSHKURTRA**

**22. Derivatet.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012. shoqeria **nuk ka** gjendje ne fund te vitit ushtrimor derivative . Shen.2.3.2.1.

**23. Huamarrjet.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria gjendje ne fund te vitit ushtrimor huamarrje afatshkurtra 6,030,351 leke qe perfaqeson over draft-in qe shoqeria jone ka terhequr per nevojat e zhivimit normal te aktivitetit te saj tregetar. Shen.2.3.2.3. .

#### **24. Huat dhe parapagimet.**

Gjendjet e huave dhe parapagimeve te poshteshenuara ne fund te vitit ushtrimor jane paraqitur me vleren nominale te shumes per t'u paguar

24.1. Te pagueshme ndaj furnitorëve

Gjendja e furnitoreve ne mbyllje te vitit ushtrimor eshte 15,216,189 leke e cila perfaqeson detyrimin e shoqerise per materialet e blera.

24.2. Te pagueshme ndaj punonjësve, nuk ka leke.

24.3. Detyrimet tatimore. Gjendja ne fund te vitit ushtrimor e detyrimeve ndaj tatim taksave perbehet nga detyrimi per sigurime shoqerore 91,924 leke dhe tatim page 24,948 leke, te muajit Dhjetor 2012.

24.4. Detyrime tatimore per tatim fitimin nuk ka pasi eshte me mbi pagese. **Shih sqarimet ne piken 8 Taksat.**

24.5. Paraqet detyrimet tatimore per T.V.Sh., e muajit Dhjetor 2012 per 0 leke.

#### **25. Grandet dhe te ardhurat e shtyra.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje grande ne fund te vitit ushtrimor. Shen.2.3.10.

#### **26. Provizionet.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje provizione ne fund te vitit ushtrimor. Shen.2.3.11.(1,2,)

### **PASIVET AFATGJATA**

#### **27. Huate afatgjata.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Huat afatgjata . Shen.2.3.2.7. .

#### **28. Huamarrje te tjera afatgjata**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje ne fund te vitit ushtrimor Huat afatgjata.

#### **29. Provizionet afatgjata.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje provizione ne fund te vitit ushtrimor. Shen.2.3.11.(1,3,4)

#### **30. Grandet dhe te ardhurat e shtyra.**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje grande afatgjata ne fund te vitit ushtrimor. Shen.2.3.10.

### **KAPITALI**

#### **31. Aksionet e pakices.**

Ky post perdoret vetem ne rastin e ndertimit te PF te konsoliduara sipas SKK. Ne kete post paraqitet ajo pjese e aktiveve neto te shoqerive te kontrolluara ne grupin e konsoliduar , qe nuk i perkasin shoqerise mëmë. Ne bilancin kontabel te vitit 2011 , shoqeria nuk ka gjendje aksione te pakices ne fund te vitit ushtrimor.

#### **32. Kapitali qe i perket shoqerise mëmë.**

Ky post perdoret vetem ne rastin e ndertimit te PF te konsoliduara sipas SKK. Ne kete post paraqitet ajo pjese e aktiveve neto te shoqerive te kontrolluara ne grupin e konsoliduar , qe i perkasin shoqerise mëmë. Ne bilancin kontabel te vitit 2012 , shoqeria nuk ka gjendje kapital qe i perket shoqerise meme ne fund te vitit ushtrimor.

**33. Kapitali aksionar.**

Ne kete post paraqitet kapitali me vlere nominale i kontribuar (kapitali i nenshkruar) (i paguar ``101`` dhe i nenshkruar i papaguar ``102``) nga aksioneret /ortake. Ky kapital eshte 24,163,000 leke. Shen. 2.3.21., si dhe shpjegimin tek informacioni i pergjithsem, 1.1.

**34. Primi i aksionit.**

Ne kete post paraqitet diferenca e vleres nominale me vleren e emetimit te kapitalit (vlere e drejte ne momentin e emetimit te kapitalit). Ne kete post paraqiten si diferenca ne plus (-104-), dhe diferenca ne minus(-105-).

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje primi te aksionit ne fund te vitit ushtrimor. Shen. 2.3.2.8.

**35. Njesite ose aksionet e thesarit (negative).**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje aksione te thesarit (negative) ne fund te vitit ushtrimor. Shen. 2.3.2.8.

**36. Rezerva statutore.**

Ne kete post paraqiten rezervimet kontabel nga fitimi i bazuar ne kerkesat e statutit te shoqerise. Ne bilancin kontabel te vitit 2012, ne fund te vitit ushtrimor shoqeria ka gjendje rezerva statutore ne nje vlere prej 299,811 leke.

**37. Rezerva ligjore.**

Ne kete post paraqiten rezervat e detyrueshme kontabel nga fitimi i bazuar ne kerkesat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje rezerva ligjore ne fund te vitit ushtrimor shumen.

**38. Rezerva te tjera. N/A**

Ne bilancin kontabel te vitit 2012, shoqeria nuk ka gjendje rezerva te tjera ne fund te vitit ushtrimor.

**39. Fitimet e pashperndara.**

Nuk ka.

**40. Fitimi (Humbja) e vitit financiar.**

Ne kete post paraqiten fitimet e periudhes ushtrimore te shoqerise ashtu si rezulton ne PASH, pasi i eshte zbritur tatim fitimi. Shih shpjegimet tek pika 7 Fitimi i shfrytezimit, si dhe detajimin e te ardhurave pika 3 dhe shpenzimeve tek pasqyrat Nr 1, 2, 3 dhe 4.

Per Shoqerine "Servis auto – 2000" shpk

Administratori

Shpetim Xhetani

Tirane me, 25 Mars 2013



Financieri

Ditjon Çunaj